

VENDIM
Nr. 35, datë 16.1.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 497, DATË 13.9.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA
SHPËRBLIM, TË ISH-GODINËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE
ARTISTËVE, NGA MINISTRIA E KULTURËS, KOMISIONIT TË PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT, INSTITUCIONE TË RIVLERËSIMIT TË GJYQITARËVE DHE
PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË PARASHIKUARA NGA
LIGJI NR. 84/2016”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 497, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, nga Ministria e Kulturës, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në titull dhe në përmbajtje, emërtesa “Ministria e Kulturës” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” dhe emërtesa “Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” zëvendësohet me emërtesat “Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.

2. Në titullin e vendimit, pas fjalëve “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, ...” shtohen “...të një pjese...” dhe hiqen fjalët “...institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016”.

3. Në pikën 1, pas fjalëve “Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, ...” shtohen “...të një pjese...”.

4. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët “Ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve” zëvendësohen me “Një pjesë e ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”;

b) fjalët “...deri në përfundim të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë (procesi i *vetting*-ut)” zëvendësohen me “...deri më 30.9.2025”.

5. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin të lidhin një marrëveshje, ku të përcaktohen modalitetet e përdorimit dhe të vënies në dispozicion të një pjese të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, si dhe kalimi kapital i pajisjeve të zyrave, sipas legjislacionit në fuqi.”.

6. Pika 5 shfuqizohet.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama